

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Shpërthen vullkani në Indonezi, mbyllen 8 aeroporte! Mbi 700 fluturime të pezulluara dhe mbi 150 mijë p asagjerë të bllokuar
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/shperthen-vullkani-ne-indonezi-mbyllen-8-aeroporte-mbi-700-fluturime-te-pez-i584350
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	redirected

KOHA


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 17:11:32 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	6 shtator 2026, 17:05:05 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f3c3368c42319791725c8841e0adb65c886641708fef27e237d0e89503975b886
TEKSTI	df0c555ca0f6a5fe7667a2fd205f811a06321b6b54ecdb1c0dd5f60a9be7b2aa
PAMJA	12b8043b53a8dba768aa0cff4fb064b88872e1b8eade2b985df691f96d3e4ef

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	90194d92c3ffff77a2677f556d1ed4c4dd927c97cc12e4ed08a13cef6935b3d34
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	a45507428a98c63085c2963d30344babdbc7610ba6cc641ac813875f5ab635aa
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/90194d92c3ffff77a2677f556d1ed4c4dd927c97cc12e4ed08a13cef6935b3d34

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



1e Shpërthen vullkani në Indonezi, mbyllen 8 aeroporte! Mbi 700 fluturime të pezulluara dhe mbi 150 mijë pasagjerë të bllokuar
fundit

Shpërthen vullkani në Indonezi, mbyllen 8 aeroporte! Mbi 700 fluturime të pezulluara dhe mbi 150 mijë pasagjerë të bllokuar

6 Shtator 2026, 19:05Bota TEMA



Shpërthen vullkani në Indonezi, mbyllen 8 aeroporte! Mbi 700

Mbi 150 mijë pasagjerë kanë mbetur të bllokuar në Indonezi pasi shpërthimi i vullkanit Anak Krakatau detyroi autoritetet të mbyllin përkohësisht tetë aeroporte për shkak të përhapjes së hirit vullkanik.

Aeroporti Ndërkombëtar Soekarno-Hatta në Xhakartë ishte i pari që ndërpreu operacionet të dielën në mëngjes, pasi hiri u zbulua në hapësirën ajrore. Më pas, pezullimi u shtri edhe në aeroporte të tjera, pasi analizat treguan se reja e hirit po lëvizte drejt Javës Perëndimore.

Ministri i Transportit, Dudy Purwagandhi, tha se deri tani janë prekur 712 fluturime dhe u kërkoi kompanive ajrore të shqyrtojnë devijimin e disa linjave drejt aeroporteve të tjera. Ai u bëri gjithashtu thirrje operatorëve të përshpejtojnë rimbursimin e biletave për pasagjerët e prekur dhe t'i informojnë në kohë udhëtarët për të shmangur grumbullimet në aeroporte.

Ndikimi më i madh është regjistruar në fluturimet drejt dhe nga Singapori, ndërsa janë prekur edhe linjat ndërkombëtare me destinacion Doha, Sidnej dhe Kuala Lumpur.

Sipas autoriteteve, Anak Krakatau nisi aktivitetin intensiv të premtën në mbrëmje, me shpërthime të njëpasnjëshme, rrjedhje llave, aktivitet sizmik të vazhdueshëm dhe zhurma të forta. Dy shpërthime të tjera u regjistruan edhe në orët e para të së dielës.

Agjencia Meteorologjike e Indonezisë bëri të ditur se hiri vullkanik arriti deri në 6 mijë metra lartësi mbi ishullin Java në lindje të vullkanit dhe deri në 15 mijë metra në anën e Sumatrës.

Autoritetet kanë konfirmuar se nuk ka rrezik për cunami si pasojë e aktivitetit të fundit të vullkanit, i cili ndodhet në Ngushticën Sunda, mes ishujve Java dhe Sumatra.

Ministria e Shëndetësisë u ka bërë thirrje banorëve të zonave të prekura të qëndrojnë brenda dhe të përdorin maska për t'u mbrojtur nga hiri vullkanik, i cili mund të shkaktojë probleme me frymëmarrjen dhe irritim të syve e lëkurës.

Sipas mediave lokale, disa shkolla kanë pezulluar aktivitetet pasi nxënësit dhe banorët raportuan irritim të syve nga hiri, ndërsa edhe peshkatarët kanë ndalur daljet në det. Një banor i zonës tha se hiri është aq i dendur sa duhet të pastrojë oborrin e shtëpisë çdo pesë minuta.

Anak Krakatau, që në shqip do të thotë “Fëmija i Krakatoas”, është një nga vullkanet më aktivë të Indonezisë. Në vitin 2018, shembja e një pjese të tij shkaktoi një cunami që vrau më shumë se 400 persona dhe plagosi e zhvendosi mijëra të tjerë në brigjet e Sumatrës dhe Javës.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Kushner dhe Witkoff bisedime me Zelenskyn në Kiev: Ishte një diskutim i rëndësishëm për afrimin e fundit të luftës](#)

18:45 Bota

[Shembet ndërtesa 5-katëshe në New Dehli, 3 viktimë dhe 8 të plagosur, nis operacioni për shpëtimin e të bllokuarve](#)

18:25 Bota

[Von der Leyen viziton Groenlandën, BE rrit mbështetjen ndaj ishullit](#)

18:05 Bota / 1 koment

[Përplasje në Cernobbio/ Vannacci kërkon frenimin e integritetit evropian: BE të jetë platformë bashkëpunimi, jo detyrimi](#)

17:45 Bota

[Turqia kërkon uljen e tensioneve mes SHBA-së dhe Iranit, Erdogan: Do të vijojmë iniciativat për paqe](#)

17:35 Bota

[Udhëtoni drejt BE-së? Nga 6 shtatori kontrollet biometrike mund të zgjasin pritjet në kufi](#)

17:15 Bota

[Nga oligarkët te familja Orbán, qeveria e re e Hungarisë nis hetimin për pasuritë e përfituara padrejtësisht](#)

17:05 Bota / 1 koment

[Shpërthen vullkani në Indonezi, pezullohen 209 fluturime dhe bllokohen mijëra pasagjerë](#)

16:35 Bota

[Kryeparlamentari i Iranit: Epoka e përgjigjeve proporcionale ndaj sulmeve amerikane ka marrë fund](#)

16:15 Bota

[“Muri mbrojtës” kundër AfD-së në provë, sondazhet e nxjerrin partinë fituese me diferencë të thellë](#)

15:55 Bota / 3 komente

Më të lexuarat

24 orët e fundit

Javën e fundit

[Berisha në Nju Jork. Kur një vakt me shqiptarët e Amerikë...](#)

12:25 Politika / 89 komente

[Shkon për vetulla, por gjen protesta - Meçe: Sali Berishë...](#)

20:55 Politika / 18 komente

[Rama përballë 300 pyetjeve, nga Sazani te SPAK dhe pasard...](#)

08:45 Politika / 46 komente

[Pronat para viteve '91/ Kadastra hap aplikimin online, pë...](#)

14:25 Sociale / 3 komente

[GJKKO nuk mund të jetë zgjatim i 313-ës!](#)

10:05 Blog / 12 komente

Blog Tema

[Vetëm 8% probabiliteti në Polymarket për rënien e qeverisë Rama këtë vit...](#)

11:03 Blog

[GJKKO nuk mund të jetë zgjatim i 313-ës!](#)

10:05 Blog / 12 komente

[Këshilla një të riu që do të bëhet gazetar](#)

09:35 Blog / 3 komente

Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Numri juaj i telefonit

Ju mund të çregjistroheni në çdo moment.

 Powered by Tomorrow.io

Tema është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, Tema është një nga gazetat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.



Built and Monetized by

- | | |
|---|--|
| <ul style="list-style-type: none">• Politika• Kronika• Editorial• Blog• Bota• Sport• Shëndeti• Turizëm | <ul style="list-style-type: none">• Sociale• Ekonomia• Antena• Rajoni• Kulturë• Lifestyle• Dossier• Hi-Tech |
| <ul style="list-style-type: none">• Kontakt• Te dhënat personale• Cookies | |

Built and Monetized by